

L I G J
Nr.8246, datë 1.10.1997

PËR INSTITUTIN E INTEGRIMIT TË TË PËRNDJEKURVE

Në mbështetje të nenit 16, pika 2 dhe të nenit 23 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Pranë Këshillit të Ministrave krijohet Instituti i Integritimit të të Përndjekurve ("IIP"), i cili si një organizëm shtetëror më vete, ka për qëllim të marrë të gjitha masat dhe të ndjekë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me integrimin në jetën e shoqërisë shqiptare të ish të përndjekurve politikë nga regjimi komunist.

Neni 2

IIP përpunon dhe trajton çështjet themelore që kanë të bëjnë me të përndjekurit në bashkëpunim me shoqatat e të përndjekurve, duke lidhur për këtë qëllim marrëveshjet përkatëse.

Neni 3

IIP ka strukturën dhe rregulloren e vet, të cilat miratohen nga Këshilli i Ministrave.
Drejtori i IIP-së emërohet dhe shkarkohet nga Këshilli I Ministrave, pasi merret mendimi i shoqatave të të përndjekurve.

Neni 4

Për të siguruar veprimtarinë e tij, IIP mbështetet në një fond buxhetor, i cili me propozimin e Këshillit të Ministrave miratohet nga Kuvendi Popullor.

IIP mund të sigurojë burime financiare edhe nëpërmjet donacioneve e projekteve të ndryshme nga donatorë vendas e të huaj ose edhe nga çdo burim tjetër i ligjshëm.

Të gjitha donacionet ose të ardhurat e tjera të ligjshme që I vijnë IIP-së, përdoren vetëm për qëllimet, për të cilat është krijuar ky Institut.

IIP informon dhe raporton në Këshillin e Ministrave për të gjitha të ardhurat financiare që sigurohen nga cilido burim.

Neni 5

Përdorimi i të ardhurave të tjera jobuxhetore do të bëhet përmes programeve e projekteve të miratuara nga Këshilli I Ministrave, me propozimin e IIP, pas konsultimeve me shoqatat e të përndjekurve.

Për kontrollin e veprimtarisë financiare të IIP ndiqen të njëjtat rregulla e procedura si për të gjitha degët e tjera të administratës shtetërore.

Neni 6

Çdo ligj ose dispozitë tjetër që bien në kundërshtim me përmbajtjen e dispozitave të këtij ligji, shfuqizohen.

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.1945, datë 6.10.1997 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani